



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 6, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 6, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.263 datë 8.05.2019, ka caktuar VNV e KZAZ nr.6 në Palestrën e Shkollës së Mesme Profesionale "Ndre Mjeda, Bashkia Vau Dejës.

Sikundër është fakt i njohur publik, palestra e Shkollës së Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", ku ishte vendosur VNV nr.6, pas ngjarjeve të datës 27.06.2019, është dëmtuar plotësisht.



Nr. 913 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 6, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 2/49, datë 25.06.2019, i ka kërkuar KQZ të vlerësojë situatën dhe shqetësimet e krijuara për KZAZ nr. 6, të cilët në kohën e dërgimit të shkresës, shpreheshin për pamundësinë e ushtrimit të detyrave në palestrën e Shkollës së Mesme Profesionale "Ndre Mjeda, Bashkia Vau Dejës. Në këto kushte Prefekti i Qarkut Shkodër, ka propozuar ndryshimin e VNV nr. 6, dhe caktimin e saj në ndërtesën "Dodani" në hyrje të qytetit të Vaut të Dejës.

Ambienti i propozuar, ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor dhe kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

ZAZ nr. 6, ka në juridiksionin e saj 53 QV, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, ambienti i VNV-së duhet të ketë sipërfaqe prej jo më pak se 200 m².

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 6, në ndërtesën "Dodani" në hyrje të qytetit të Vaut të Dejës, me sipërfaqe 420 m².
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 913 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 6, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019